



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273971
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05340476

C – IV. – 15 – 0925

Paditësi :

R M nga fshati R i Komunës së Prizrenit, e të cilin me autorizim e përfaqëson av. V R nga Prishtina.

Kundër

E paditura :

NSh, "Kosova Vera" me seli në Krushë të Vogel Prizren, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Obekti i çështjes : Kompensimi i pagave 3 (tri) pagave të pa paguara.

Për: Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me **dt.16.02.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, R M nga Prizreni e ushtruar kundër Vendimit, PRZ002-0206 të dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, e me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 412.20 €, për periudhën e pa përcaktuar nga NSH, "Kosova Vera" me seli në Prizren, dhe i njëjti Vendim, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi me dt.23.05.2015 përmes postës pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), ka paraqitur ankesë kundër Vendimit, PRZ002 – 0206 i dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e me të cilin, të njëjtit i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 412.20 € për periudhë të pa përcaktuar nga Ndërmarrja Shoqërore, NSH, "Kosova

Vera” me seli në Prizren (në Likuidim). Padiësi vendimin e ka atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të gjendjes materiale, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta aprovoje kërkespadinë e padiësit dhe ta anuloj vendimin e ankimuar. Me tej padiësi ka theksuar se i janë kufizuar të drejtat e tij dhe i njëti është diskriminuar me vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Padiësi kësaj padie, ia ka bashkangjitur si provë: kopjen e Vendimit, PRZ002 – 0206 i dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL).

Pala padiëse parashtresën e ka titulluar si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 - 0925 të dt.11.07.2023, gjykata ka urdhëruar padiësin që të plotësoj ankesën siç është përshkruar me gjerësisht në urdhër, dhe se pas pranimit të tij, nga i autorizuari i padiësit, me dt.14.07.2023, i njëjti deri më tani, nuk ka vepruar sipas këtij urdhri.

Me dt.23.08.2023, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – IV – 15 – 0925 të dt. 23.08.2023, padinë e padiësit e me provat e bashkangjitura, ia ka dërguar të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë.

Me dt.11.09.2023, e paditura AKP me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas urdherit të kësaj gjykate, C – IV – 15 – 0925 të dt. 23.08.2023, ka parashtruar mbrojtje (përgjigje) ndaj ankesës së padiësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PRZ002-0206 të dt. 27.04.2015, të Autoritetit të Likuidimit (AL), e në të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi ekzistencën dhe lartësinë e pretendimit të parashtruesit se AL-ja, ka kryer një vlersim të sakt të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht, ku i përmbaht qëndrimin se AL ka bërë një vlersim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitave ligjore dhe se Vendimi i AL-së, është marrë në pajtim me nenin 36.2 nën paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në, : “*se elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë kërkesa apo pretendimi se është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, se padia/ankesa e padiësit është e pa pranueshme sepse objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin, Nr.04/L-034). Padiësi nuk ka cekur se cili nen i Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, është shkelur nga AL-ja, se pretendimet e padiësit janë të parashtruara sepse në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, bënë fjalë për kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta, se kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”, dhe se neni 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, parashikon që: “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit, që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet” dhe i ka propozuar gjykatës që t’a refuzoj si të pa pranueshme dhe të pabazuar ankesën e padiësit dhe t’a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.06/L – 086, dhe se si provë, ia ka bashkangjitur kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRZ002-0206 të dt. 27.04.2015 dhe Vendimin për emërimin e anëtarëve të bordit.*

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 - 0925 te dt.11.09.2023, gjykata , ia ka dërguar padiësit mbrojtjen (përgjigjen) e të paditurës ndaj ankesës së padiësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së,

PRZ002-0206 të dt. 27.04.2015 dhe se të njëjtën e ka pranuar me datë 19.09.2023, dhe se deri më tani, nuk ka prova se ka vepruar sipas këtij Urdhri.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DhPGJJK-së, lidhur me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, është e pabazuar.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se NSh “Kosova Vera ” me seli në Prizren, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.09.09.2013, ndërsa paditësi kërkesën në Agjencinë Kosovare të Privatizimit e ka paraqitur me dt.10.10.2013, tek AL-ja, për kompensimin e tri pagave të pa paguara në shumën prej 412.20 €, për periudhën e pa përcaktuar. Autoriteti i Likuidimit me Vendimin, PRZ002-0206, të dt 27.04.2015, kërkesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar, kundër të cilit Vendim paditësi ka parashtruar ankesë pranë DhGjSK-së, me dt. 23.05.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të tij.

Gjykata për rastin në fjalë si datë e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit, merr për bazë datën 26.02.2010, kur parashtruesi i ankesës nuk ka përfutur të ardhurat personale gjegjësisht data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si pasojë e privatizimit të NSh-së, “Kosova Vera” me seli në Prizren, dhe të pretenduara për kompensim nga NSh-ja në fjalë, si e paditur dhe se në bazë të dispozitave së mësipërme ligjore, kërkesa nga ana e paditësit, do të duhej të parashtrohej pranë ndonjë gjykate apo autoriteti kompetent brenda 3 (tre) vjetëve nga momenti kur parashtruesi - paditësi, e kishte fituar të drejtën për të dorëzuar kërkesën për kompensim për pagat e papaguara, pra duke filluar nga data 26.02.2010 dhe se sipas vlerësimit të gjykate, kërkesa e parashtruesit të ankesës lidhur me kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 412.20 €, është parashkruar më 26.02.2010, kurse pagat e pretenduara të më hershme janë parashkruar në përlllogaritje me kohën veç e veç për secilën pagë mujore të pretenduar me kalimin e afatit prej 3 vite, ndërsa kërkesa e saj është parashtruar fillimisht në Autoritetin e Likuidimit me dt.09.09.2013 kurse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGKSK), është parashtruar ankesë me dt.23.05.2015 dhe atë kundër Vendimit, PRZ002 – 0206 të dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh, ”Kosova Vera” (në Likuidim) e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën e lartë cekur por pa periudhë të caktuar kohore.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar, është jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSh-ja në fjalë, pasi që paditësi, nuk ka arritur që të

bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore duke ushtruar padi për kompensim nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, kanë në dispozicion arkivat për lëndën aktive të iniciuara nga palët para vitit 1999 dhe me kërkesë të palës nxjerrin parashtrësia për të dëshmuar iniciimin e procedurave gjyqësore dhe se për këtë arsye edhe kërkesa e paditësit, është kërkesë e parashkruar në kuptim të nenit 36.2 nën paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Për më tepër pala paditëse, nuk e ka bërë plotësimin e padisë së tij sa i përket periudhës kohore për të cilën kërkon kompensimin e këtyre pagave edhe pse gjykata, me urdhrin e saj, C – IV. – 15 - 0925 të dt.11.07.2023, ka kërkuar këtë plotësim të padisë së tij si dhe se me urdhrin e saj, C – IV. – 15 - 0925 te dt.11.09.2023, e ka urdhëruar që mund të paraqiste Përgjigje në Mbrojtjen (Përgjigjen) në padi të të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë .

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *''Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës''* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (I publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* e për më tepër edhe në nenin 77 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Në nenin 74 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) që flet për çështjen e shqyrtimit të Vendimeve të Autoritetit për likuidim, aty thuhet se: *''Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose asetit sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi''*. Po ashtu në zbatim të dispozitës së nenit 40 par.1 pika 6.1 të Shtojcës të Ligjit për AKP-në, aty citohet se: *“Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person”*.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës , parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe*

të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla". Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesëpadinë e paditësit, R M nga fshati Ri Komunës së Prizrenit, të ushtruar kundër Vendimit, PRZ002 – 0206 të dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh, "Kosova Vera" me seli në Prizren (në Likuidim), duhet t'a refuzojë si të pabazuar dhe Vendimin, PRZ002– 0206 të dt.27.04.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL), duhet t'a vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj .

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale sepse në këtë çështje kontestimore, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:273971, 16.02.2024

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).